



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE



**RAPORT I INSPEKTIMIT**  
**”PERFORMANCA POLICORE NË REALIZIMIN E URDHËRESAVE TË**  
**GJYKATAVE”**

Nr. 8/2021

Prishtinë, 31 dhjetor 2021

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit Performanca policore në realizimin e urdhëresave të gjykatave
<b>Data e përgatitjes</b>	31 dhjetor 2021
<b>Realizuar nga</b>	Ilir Idrizaj, udhëheqës i ekipit të inspektimit, Kushtrim Jonuzi, inspektor, Mirsad Puqurica, inspektor, Servet Tasholli, inspektor, Shqiponjë Sopi, inspektor, Teuta Rukolli, inspektor, Xhavit Fetahaj, inspektor
<b>Mbikëqyrur nga</b>	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>orëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	31 dhjetor 2021



---

© Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (IPK) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet. Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,  
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali, Prishtinë,  
Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201  
E-mail: [zimp.ipk@rks-gov.net](mailto:zimp.ipk@rks-gov.net)

<b>1. Përmbledhja ekzekutive</b>	
1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....	(4-4)
<b>2. Hyrje</b>	
2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....	(5-5)
2.2. Qëllimi.....	(5-5)
2.3. Objektivat e inspektimit.....	(5-5)
2.4. Rëndësia e inspektimit.....	(6-6)
2.5. Metodologjia e inspektimit.....	(6-6)
<b>3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet</b>	
3.1. Baza ligjore dhe kapacitetet policore.....	(7-9)
3.2. Indikatorët e performancës dhe trendët.....	(9-12)
3.3. Aktivitetet policore në administrimin e urdhëresave.....	(12-16)
<b>4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve</b>	
4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....	(17-19)

## 1. Përmbledhja ekzekutive

---

### 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit (gjetjet kryesore)

1.1.1. Policia e Kosovës, mes tjerash në kuadër të detyrave dhe autorizimeve të saj, vepron edhe në ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave, të cilat mund të kategorizohen në disa grupe. Me këto urdhëresa, organet e drejtësisë ngarkojnë Policinë që të sjellin para tyre të dyshuarit dhe të dënuarit që mund të lidhen me vepra të ndryshme penale apo dhe kundërvajtëse. Kjo fushë është e rregulluar me dispozita të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm, *KPP*), Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligjin e Policisë dhe Procedurat Standarde të Operimit (PSO). Gjatë punës së përditshme, Policia pranon numër të madh të urdhëresave të gjykatave, përfshirë edhe urdhër arreste, letër rreshtime dhe urdhëresa me burg. Inspektimi vë në pah nevojën e rishikimit të PSO-së për Ekzekutimin e Urdhëresave të Gjykatave për të qartësuar ndarjen e detyrave tek strukturat që nuk kanë njësi të veçanta për administrimin e urdhëresave, si dhe veprimet që duhet ndërmarrë në rastet e skadimit të urdhëresave që nuk pasohen me vendime të reja.

1.1.2. Stacionet policore raportojnë në baza periodike në instancat rajonale lidhur me statistikat e urdhëresave, por raportet ekzistuese të hartuara nga niveli rajonal nuk japin pasqyrë të saktë mbi evidencat dhe theksi vëhet tek urdhëresat e bartura nga vitet e kaluara, të cilat nuk janë trajtuar në nivel të duhur. IPK ka ekzaminuar disa probleme që e përcjellin Policinë në këtë fushë, andaj edhe ka rekomanduar një numër masash (veprimesh) që do të mund të përmirësojnë performancën e saj, përfshirë edhe rishikimin e cilësisë së evidencave. Marrë parasysh të dhënat statistikore për vitet 2019 - 2020, shihet një rënie e efektivitetit të drejtorive rajonale në realizimin e urdhëresave, që mund të jetë edhe si rezultat i angazhimit policor në zbatimin e masave anti Covid. Derisa numri i urdhëresave të pa realizuara në vitin 2019 ka qenë rreth 1/3 e totalit të urdhëresave të disponueshme (të bartur nga vitet paraprake dhe të pranuar gjatë vitit përkatës), në vitin 2020, numri i urdhëresave të pa realizuara përbën rreth 1/2 e totalit të urdhëresave. Janë dalluar disa Drejtori Rajonale (DRP), që kanë performuar jo kënaqshëm në raport me drejtoritë tjera dhe që duhet mobilizuar në ngritjen e efektivitetit dhe performancës (Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan).

1.1.3. Në kuadër të drejtorive rajonale janë hasur disa praktika të pranimit të urdhëresave nga gjykatat, përfshirë atë përmes nivelit qendror, dhe në mënyrë të decentralizuar, të realizuar direkt përmes stacioneve. Janë hasur format e pranimit dhe dorëzimit të urdhëresave në të gjitha stacionet policore. Një numër stacionesh policore kanë njësi të veçanta që administrojnë urdhëresat, derisa të tjerat i realizojnë përmes sektorëve dhe njësisë reaguese. Lidhur me regjistrimin e urdhëresave në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), është hasur në 22 raste kur urdhër arrestet apo letër rreshtimet nuk janë regjistruar në bazën e të dhënave SIPK. Janë identifikuar 11 raste kur personat e kërkuar kanë lëvizur përmes pikave të kalimit kufitar në mungesë të regjistrimit të gjashtë (6) letër rreshtimeve dhe pesë (5) urdhër arresteve. Veç mungesës së regjistrimit në SIPK të disa prej urdhëresave, janë identifikuar edhe vonesa në regjistrimin me kohë të tyre. Kontrolli i lëndëve vë në dukje veprime të pamjaftueshme policore në realizimin e urdhëresave, apo të pakta në numër. Ka vërejtje edhe sa i përket pasqyrimit të veprimeve policore në kuadër të dosjeve duke i bërë dosjet e pakompletuara me shkresa përcjellëse. Inspektimi pasqyron nevojën e ngritjes së seriozitetit dhe përkushtimit policor në përditësimin e të dhënave në SIPK lidhur me urdhëresat e gjykatave, të cilat parashkruhen apo revokohen.

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Departamenti i Inspektimit ka filluar punën në korrik të vitit 2006, kur është themeluar dhe vet agjencia. IPK synon të forcojë besimin e publikut në Policinë dhe këtë e bën përmes shqyrtimit të pavarur dhe raportimit objektiv. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet mbikëqyrës ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik e të përgjegjshëm. IPK-ja zhvillon inspektime të bazuara në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, por edhe inspektime të jashtëzakonshme, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Kryeshefit Ekzekutiv. Është identifikuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, një fushë që shtron nevojën për trajtim të vazhdueshëm e që mund të jetë e ndjeshme. Është kjo fusha e trajtimit dhe zbatimit të urdhëresave të gjykatave, me administrimin e të cilave merren stacionet policore. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për IPK-në me qëllim që të vlerësohet nëse Policia është e angazhuar sa duhet në ekzekutimin e urdhëresave të tilla. Kjo fushë nuk është trajtuar sa duhet në të kaluarën dhe inspektimi paraqet mundësi për të vlerësuar mënyrën se si administrohen urdhëresat, cilat janë kapacitetet e angazhuara në realizimin e tyre, sa janë efektive strukturat e stacioneve policore në zbatimin e tyre dhe sa mirëmbahen evidencat. Bazuar në këtë, më 12 nëntor 2021, Kryeshefi Ekzekutiv ka autorizuar fillimin e inspektimit të jashtëzakonshëm, për të vlerësuar performancën policore në zbatimin e urdhëresave. IPK-ja nuk ka kryer më parë inspektim të kësaj fushe. Inicimi i inspektimit është ndikuar dhe nga nevoja që Policia të sigurohet që siguri publike po i jepet prioritet i duhur, drejt ofrimit të një mjedisi më të sigurtë për qytetarët.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, si dhe parimet dhe procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me realizimin e urdhëresave;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse;
- Që të identifikojë mangësitë - dobësitë dhe rekomandoj masa për funksionim më të mirë.

### **2.3. Objektivat e inspektimit**

2.3.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të identifikohen dhe vlerësohen procedurat e veprimit, si dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të angazhuara në zbatimin e urdhëresave;
- Të matet dhe vlerësohet performanca, si dhe efikasiteti i stacioneve policore në zbatimin e urdhëresave të gjykatave;
- Të vlerësohet mbajtja e evidencave mbi pranimin, regjistrimin, ekzekutimin dhe shlyerjen e urdhëresave.

## 2.4. Rëndësia e inspektimit

2.4.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Kontribuimin e krijimit të një mjedisi më të sigurtë shoqëror;
- Ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në zbatimin e urdhëresave të gjykatave;
- Ngritjen e transparencës dhe besueshmërisë së publikut në shërbimet e sigurisë.

## 2.5. Metodologjia e inspektimit

2.5.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm është vlerësuar kryerja e detyrave gjatë administrimit të urdhëresave të gjykatave vendore. Inspektimi është përqendruar në të gjitha zyrat e evidentimit dhe ekzekutimit të urdhëresave në kuadër të stacioneve policore, Zyrën e Sistemit të Menaxhimit Kufitar dhe Zyrën Qendrore të SIPK. Gjetjet e këtij inspektimi duhet të jenë në interes të të gjithë akterëve, përfshirë strukturën ekzekutive dhe nivelet mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse.

2.5.2. Gjatë inspektimit është aplikuar metodologji adekuate inspektuese, e cila ofron mundësi për të siguruar informacionin e nevojshëm në interes të nxjerrjes së opinionit objektiv mbi proceset e fokusuar. Në këtë drejtim:

- a) Janë zhvilluar takime- intervista me 50 drejtues, punonjës e bartës funksionesh, përfshirë: administratorë të urdhëresave dhe zyrtarë të SIPK-ut;
- b) Janë kryer inspektime - kontrole fizike të 171 dosjeve të urdhëresave të gjykatave për vitet 2019 dhe 2020 (të parashkruara/skaduara) dhe regjistrave (evidencave);
- c) Janë marrë dokumente të shkruara, si: dëshmi mbi kapacitetet, raportet periodike të punës dhe kopjet e dosjeve të urdhëresave (171 sosh).

2.5.3. Bazuar në Programin e punës, inspektimi ka filluar më 18.11.2021 dhe është planifikuar të përfundojë më 24.11.2021, por takimet konsultuese me zyrtarë përgjegjës kanë vazhduar dhe përtej datës së planifikuar të përfundimit të punës në terren. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhës dy vjeçare (2019/2020) dhe gjendjen aktuale.

2.5.4. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Baza ligjore dhe kapacitetet dhe evidencat,
- Indikatorët e suksesit dhe performanca policore.

2.5.5. Dokumentet në vijim janë baza themelore (standardet), në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave:

- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;
- Procedura Standarde e Operimit - Ekzekutimi i Urdhëresave të Gjykatave;
- Procedura Standarde e Operimit - Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës.

2.5.6. Gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës. Inspektorët kanë hasur në një bashkëpunim të kënaqshëm të personelit policor. Raporti përfundimtar iu ka nënshtruar proceseve të brendshme të kontrollit të cilësisë. Po ashtu, është realizuar edhe takim me përfaqësues të strukturës policore, ku janë diskutuar gjetjet, rekomandimet dhe Plani i implementimit të tyre (30.12.2021).

### 3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

---

#### 3.1. Baza ligjore dhe kapacitetet policore

3.1.1. Puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit, andaj Policia ndërmer veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbulojë veprat penale dhe të kapë kryesit e tyre. Me Ligjin për Policinë, një ndër detyrat dhe autorizimet e Policisë është parandalimi dhe zbulimi i veprave penale dhe kryesit e tyre<sup>1</sup>. Në luftimin dhe zbulimin efikas të krimit, për kapjen e kryesve të veprave penale nga organet e ndjekjes, me dispozitat e KPP-së janë paraparë shtatë (7) masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale<sup>2</sup>. Urdhërarresti është njëra nga masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale, që lëshohet nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare me kërkesë të prokurorit të shtetit ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 të KPP-së, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull, nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, ose kur thirrja nuk ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimin të thirrjes. Urdhërarresti nëse nuk përcaktohet ndryshe, skadon në mesnatën e ditës së 365-të nga dita e lëshimit dhe si i tillë ekzekutohet nga Policia. Zyrtari i policisë i ngarkuar për ekzekutimin e urdhrin ia dorëzon këtë të pandehurit dhe kërkon nga i njëjti që ta shoqërojë dhe nëse ai këtë e refuzon, atëherë dërgohet forcërisht<sup>3</sup>.

3.1.2. Kur vendbanimi i përhershëm apo i përkohshëm i të pandehurit nuk dihet, me dispozitat e këtij Kodi, Gjykata kërkon nga Policia që i pandehuri të kërkohet dhe që Gjykata të njoftohet për adresën e tij<sup>4</sup>. Kur i pandehuri gjendet në arrati, e kundër të cilit është filluar procedura penale për vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën mund të shqiptohet sipas ligjit, dënim me të paktën dy (2) vjet burgim dhe kur është lëshuar urdhërarrest ose aktvendim për caktimin e paraburgimit, edhe në rastet kur i pandehuri është arratisur nga institucioni ku mbanë dënimin, pavarësisht nga lartësia e dënimit, ose kur është arratisur nga institucioni ku mbanë masën e trajtimit të detyrueshëm që konsiston me heqje lirie, si dhe në rastet kur personi i kërkuar nuk gjendet në Kosovë ose ka prova se personi banon jashtë Kosovës, Gjykata apo institucioni për vuajtjen e dënimit lëshon letërreshtim, më të cilin urdhëron Policinë për zbatimin e tij.<sup>5</sup> Edhe me Ligjin nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parashihet lëshimi i letërreshtimit, sipas të cilit, kur personi i dënuar, i cili është thirrur me rregull për mbajtje të dënimit nuk paraqitet në institucionin korrektues, gjykata urdhëron që ai të sjellet me forcë. Nëse personi i dënuar fshihet, ose është në arrati, Gjykata urdhëron shpalljen e letërreshtimit<sup>6</sup>.

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/L-076 Për Policinë, Kreu i II - Neni 10 (Detyrat dhe autorizimet e Policisë).

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale, Neni 173 (Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit).

<sup>3</sup> Kodi i Procedurës Penale, Neni 175 (Urdhërarresti).

<sup>4</sup> Kodi i Procedurës Penale, Kapitulli XXXVII - Procedura për dhënien e letërreshtimit, Neni 534 (Kërkimi i adresës së të pandehurit).

<sup>5</sup> Kodi i Procedurës Penale, Kapitulli XXXVII - Procedura për dhënien e letërreshtimit, Neni 53 (Kushtet për dhënien e letërreshtimit).

<sup>6</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Neni 18 (Sjellja me forcë e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit).

3.1.3. Me dispozitat e KPP-së është përcaktuar mënyra e dërgimit të shkresave nga organet gjyqësore, tek palët e përfshira në procedurë penale, si të pandehur apo dëshmitarë. Gjykata apo Prokurori i Shtetit mund të urdhërojë Policinë e Kosovës që të bëjë dërgimin e shkresave, nëse përpjekjet për dërgimin e shkresave me postë apo nëpërmjet të organit kompetent komunal nuk kanë sukses, apo kur personi i thirrur nuk paraqitet, si dhe kur Gjykata çmon se personi me gjasë nuk do të veproj në pajtim me thirrjen<sup>7</sup>. Marrë parasysh këtë obligim që ka paraparë ligji, stacionet kanë ngritur shqetësime se janë të ngarkuara jashtëzakonisht shumë me numër të madh të detyrave për dërgimin e shkresave të gjykatave tek palët dhe se Policisë i kushton në kohë dhe personel.

3.1.4. Përveç përmbledhjes së dispozitave të KPP-së dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me pranimin dhe trajtimin nga Policia të urdhëresave të gjykatës, në vitin 2010 është nxjerrë Procedura Standarde e Operimit (ZENDPO/0135/2010) për Ekzekutimin e Urdhëresave të Gjykatës, që orienton drejtoritë regjionale dhe stacionet policore të veprojnë në mënyrë unike në ekzekutimin e urdhëresave dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme, përfshirë fazat nga pranimi e deri te ekzekutimi i tyre. PSO-ja u lë në kompetencë drejtorive rajonale dhe stacioneve policore që varësisht prej specifikave të tyre organizative, të zgjedhin format efikase për ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave, nëse të njëjtat do të krijojnë njësi të veçanta që do të merren me këtë aktivitet, ose urdhëresat t'iu ngarkohen njësisive të stacioneve policore. Meqenëse PSO është nxjerrë para së të ndryshohet KPK-ja dhe Ligji për Gjykatat, është e nevojshme që të rishikohet PSO në përputhje me legjislacionin aktual. Inspektimi vë në pah disa dobësi që ka PSO aktuale, ngase edhe pse u ka lënë hapësirë stacioneve të rregullojnë organizimin mbi administrimin e urdhëresave, në anën tjetër nuk ka rregulluar ndarjen e detyrave varësisht modaliteteve, p.sh, kush do të administroj urdhëresat nëse nuk ka të angazhuar njësi të veçantë të ekzekutimit. Kjo çështje që u ngrit, vjen si rezultat i gjetjeve të inspektimit, por që do të trajtohet në brendësi të raportit. Meqë Policia ndodhet në fazën e rishikimit funksional organizativ, duhet marrë parasysh brengat e drejtuesve policor, që administrimi i urdhëresave të mund të ngarkojë njësi të veçanta, puna e të cilave do të ishte më efikase. Inspektimi ka hasur edhe në mungesë udhëzimesh se si duhet vepruar në rastet kur urdhër arrestet parashkruhen (skadohen) e nuk pasohen me urdhra tjerë. Marrja parasysh e kësaj çështjeje dhe trajtimi në kuadër të rishikimit do të lehtësoj veprimet në realizimin efektiv të urdhër arresteve.

#### **Rekomandimi nr. 1**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Policisë së Kosovës, të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të Procedurës Standarde të Operimit për Ekzekutimin e Urdhëresave të Gjykatave, duke synuar ndarjen e qartë të detyrave të personelit, të ngarkuar në administrimin dhe ekzekutimin e tyre, varësisht organizimit brenda stacioneve policore.*

3.1.5. Në drejtim të mbajtjes së evidencave mbi urdhëresat e gjykatave, deri më 28 nëntor të vitit 2021, Policia ka pasur në funksion, Procedurën Standarde të Operimit - Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës (ZDPO-02/020/14), e cila është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Procedurës Standarde të Operimit - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës (DPPK-01/0852 /21). PSO-ja e shfuqizuar, që ka qenë edhe objekt i inspektimit, ka përcaktuar strukturën organizative të SIPK, përgjegjësitë lidhur me përgatitjen, ruajtjen, evidentimin, azhurnimin e përdorimin e informatave që i disponon SIPK-u. Kjo PSO ka përkufizuar edhe klasifikimin e informatave, metodologjinë e

<sup>7</sup> Kodi i Procedurës Penale, Neni 475 - Mënyra e dërgimit të shkresave.



regjistrimeve të të gjitha rasteve policore, në të cilat përfshihen veç tjerash dhe urdhër arrestet dhe letër rreshtimet. Këto të fundit përfshijnë regjistrimin e të gjitha urdhëresave të lëshuar nga gjykatat kompetente, duke u dhënë udhëzime zbatuesve të ligjit, t'i arrestojnë personat dhe t'i sjellin para drejtësisë. Kjo PSO, kur i referohemi detyrave të zyrtarëve për futjen dhe evidentimin e të dhënave në SIPK, ndër detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të stacioneve ka përcaktuar edhe freskimin e të gjitha të dhënave të hyra, futura në bazën e të dhënave, menjëherë pasi të arrijnë informatat e reja që janë në pritje, si dhe regjistrimin e urdhër arresteve të gjykatave kompetente.

### **3.2. Indikatorët e performancës dhe trendet e urdhëresave**

3.2.1. Gjatë realizimit të inspektimit, IPK fillimisht është pajisur me raportet statistikore të DRP-ve lidhur me urdhëresat e gjykatave, por gjatë takimit me të gjithë përgjegjësit e drejtorive rajonale dhe stacioneve policore u vë në pah një paqëndrueshmëri sasiore dhe cilësore e evidencave. Në shumicën e rasteve, të dhënat mbi numrin e urdhëresave të gjykatave për dy (2) vitet e fundit janë pasqyruar me pasaktësi, që vijnë si pasojë e mos regjistrimit të duhur të mbetjeve dhe bartjeve të numrit të tyre nga viti në vit. Evidencat kanë pasur paqartësi edhe lidhur me atë se a përfshijnë të gjitha llojet e urdhëresave, apo vetëm ato penale. Janë disa faktorë që kanë sjellë këtë gjendje, ku veç tjerash duhet përmendur kontrollin jo adekuat të drejtuesve mbi administrimin e urdhëresave të gjykatave, lëvizjet në personel, mungesa e njohurive të mjaftueshme të administratorëve mbi procedurën dhe mbajtjen e evidencave lidhur me urdhëresat e gjykatave, etj. Administratorët e urdhëresave gjatë takimeve të ndara me IPK-në kanë shprehur shqetësimet e tyre mbi mungesën e trajnimeve të veçanta për mbajtjen e evidencave dhe të një Udhëzuesi që do të përcaktonte veprime konkrete lidhur me trajtimin e urdhëresave. Si rezultat i mos trajtimit unik të mbajtjes së lëndëve, është më se e vështirë të nxirren raporte me të dhëna të sakta për sistemimin, kategorizimin dhe raportimin e lëndëve nga Policia e Kosovës. Kjo dukuri e vështirëson tej mase pasqyrimin real të gjendjes së drejtorive rajonale, përkatësisht stacioneve policore, lidhur me numrin dhe ngarkesën me lëndë të urdhëresave të gjykatave.

3.2.2. Vizitat shtesë të IPK-së në disa prej stacioneve policore kanë bërë të mundur një pasqyrim më ndryshe të numrit të urdhëresave të gjykatave. Trajtimi shtesë, i cili iu është bërë evidencave, vë në pah mospërputhje në 15 raste në mes të evidencave të stacioneve policore me ato rajonale. Këto dobësi rrezikojnë të paraqesin evidencat si jo të besueshme dhe aq më keq krijojnë imazhin për një shoqëri të rrezikuar nga krimi. Evidencat e stacioneve policore nga DRP - Mitrovicë Veriu janë përcjellur me mungesë informacionesh mbi lëndët e parashkruara, si rezultat i gabimit në përkthim të Raportit standard mbi urdhëresat e gjykatave. Ky Raport nuk përmban të dhënat mbi Stacionin Policor - Graçanicë, meqë ato janë të papërputhshme. Forma e përdorur e raportimit e cila ka filluar këtë vit, duke ndarë urdhëresat sipas llojeve, në ato penale, për kundërvajtje dhe të tjera, është një sinjal se në të ardhmen do të mund të kemi një pasqyrë më të qartë të statistikave mbi urdhëresat e gjykatave. Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK vlerëson të nevojshëm një Pako veprimesh të drejtuesve të stacioneve policore dhe të drejtorive rajonale, në drejtim të mobilizimit për të krijuar sistem të qëndrueshëm të administrimit të urdhëresave dhe mbajtjes së evidencave. Pakoja e veprimeve duhet të përfshijë stabilizimin e pozitave - vendeve të punës me administratorë që do të merren me administrimin e urdhëresave të gjykatave, organizimin e trajnimit të veçantë mbi administrimin e urdhëresave (përfshirë edhe evidencat), hartimin e një Udhëzuesi veprimesh mbi administrimin e urdhëresave, dhe rishikimin e cilësisë së evidencave, të përcjellur me kontroll të statusit të urdhëresave të kaluara.

**Rekomandimi nr. 2**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që të mobilizohet në nxjerrjen dhe zbatimin e Pakos së veprimeve, që do të ngriste cilësinë e raportimit dhe mbajtjes së duhur të evidencave mbi urdhëresat. Pakoja duhet të marrë parasysh stabilizimin e vendeve të punës në administrimin e urdhëresave, organizimin e trajnimit të personelit, nxjerrjen e udhëzuesit për administrim të urdhëresave, rishikimin e statusit të urdhëresave dhe përpunimin e të dhënave.*


3.2.3. IPK-ja ka nxjerrë disa indikatorë të performancës së stacioneve lidhur me ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave për vitin 2019 dhe 2020. Sipas të dhënave të stacioneve, në vitin 2019 janë realizuar rreth 61% e urdhëresave të disponueshme, ku janë përfshirë urdhëresat e bartura nga vitet paraprake dhe ato të pranuar gjatë vitit përkatës. Kurse, në vitin 2020, është realizuar rreth 50% e totalit të urdhëresave të disponueshme. Rënia e përqindjes së realizimit të tyre vlerësohet të jetë rezultat i angazhimit të kapaciteteve në zbatimin e masave anti Covid-19. Mesatarja e lëndëve të parashkruara në nivel të të gjitha drejtorive arrinë në 4% për vitin 2019 dhe 3% për vitin 2020 të totalit të përgjithshëm të urdhëresave. Mesatarja e numrit të përgjithshëm të urdhëresave të pa realizuara dhe të mbetura në fund të vitit 2019 e 2020 për të gjitha drejtoritë sillet të jetë rreth 35%, përkatësisht 47% e totalit të përgjithshëm të urdhëresave të disponueshme. Marrë parasysh këta tre indikatorë, kemi rënie të efektivitetit të drejtorive në ekzekutimin e urdhëresave dhe ngritje të numrit të urdhëresave të porealizuara. Tre drejtori rajonale kanë performuar më dobët në realizimin e urdhëresave, krahasuar me drejtoritë tjera (Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan). Drejtoritë, si: Pejë, Mitrovicë Veriu dhe Prizren kanë shënuar performancë më pozitive në raport me drejtoritë tjera.

**Tabela nr. 1 - Indikatorët e performances dhe efektivitetit të drejtorive rajonale policore në ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave (2019-2020)<sup>8</sup>**

	Statusi	Fe	Gjk	Gjl	MJ	MV	Pe	Pr <sup>9</sup>	Pz	Total
2019	Bartur	2.182	652	741	359	35	1.250	6.498	1.040	12.757
	Pranuar	2.788	2.011	1.041	1.151	490	3.926	6.879	3.660	21.946
	Gjithsej	4.970	2.663	1.782	1.510	525	5.176	13.377	4.700	34.703
	Realizuar	2.534	1.965	966	981	461	4.346	6.143	3.737	21.133
	%	51%	74%	54%	65%	88%	84%	46%	80%	61%
	Parashkruar	200	187	181	66	13	76	584	57	1.364
	%	4%	7%	10%	4%	2%	1%	4%	1%	4%
	Mbetur	2.236	511	635	463	51	754	6.650	906	12.206
%	45%	19%	36%	31%	10%	15%	50%	19%	35%	
2020	Bartur	2.236	511	635	463	51	754	6.650	906	12.206
	Pranuar	2.022	1.790	680	905	303	1.915	4.893	1.991	14.499
	Gjithsej	4.258	2.301	1.315	1.368	354	2.669	11.543	2.897	26.705
	Realizuar	2.076	1.650	649	785	251	2.065	3.699	2.128	13.303
	%	49%	72%	49%	57%	71%	77%	32%	73%	50%
	Parashkruar	135	112	168	36	19	38	397	44	949
	%	3%	5%	13%	3%	5%	1%	3%	2%	3%
	Mbetur	2.047	539	499	547	83	576	7.447	725	12.463
%	48%	23%	38%	40%	24%	22%	65%	25%	47%	

<sup>8</sup> Të dhënat statistikore nuk përfshijnë të dhënat e njëjësive hetimore në kuadër të regjioneve.

<sup>9</sup> Tek të dhënat e DRP - Prishtinë nuk janë përfshirë të dhënat e Stacionit Policor të Graçanicës.



3.2.4. Duke konsideruar se ngarkesa me numër të urdhëresave të gjykatave nuk mund të jenë e njëjtë për të gjitha stacionet, IPK ka realizuar edhe analiza shtesë duke krahasuar numrin e tyre në raport me numrin e zyrtarëve policor. Kjo analizë pasqyron ndryshime, që shtrton nevojën për qasje më ndryshe sa i përket efektivitetit të stacioneve policore në realizimin e urdhëresave të gjykatave. Përgjithësisht një zyrtar policor ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 11 urdhëresa në vitin 2019 (prej të cilave, ka realizuar 7 dhe 4 të tjera i ka bartur në vitin pasues) dhe me 7 urdhëresa në vitin 2020 (prej të cilave, 4 i ka realizuar dhe 3 të tjera i ka bartur). Në nivel të të gjitha drejtorive rajonale ka dalur se një zyrtar policor gjatë vitit 2019 ka realizuar 64% të urdhëresave, me të cilat është ngarkuar, derisa në vitin 2020 kjo përqindje ka ra në 57%. Ngarkesën më të madhe me urdhëresa gjatë vitit 2019 dhe 2020 e kanë pasur zyrtarët policor nga DRP - Ferizaj e Prishtinë, që del të jetë edhe një nga faktorët e performancës negative, derisa më së paku të ngarkuar me urdhëresa kanë qenë zyrtarët nga DRP - Mitrovicë Veriu. Bazuar në analizën mbi efektivitetin dhe performancën policore të drejtorive dhe stacioneve policore, konsiderohet se përgjithësisht më i suksesshëm në realizimin e urdhëresave del të jetë një zyrtar policor nga DRP - Pejë, ngase krahas ngarkesës me urdhëresa, ka përqindje më të lartë të realizimit të tyre (sipas matjeve del se një zyrtar ngarkohet mesatarisht me 13, përkatësisht 6 raste për vitet 2019 e 2020 dhe arrinë të realizoj 11, përkatësisht 5 prej tyre). Performancë të suksesshme konsiderohet të ketë edhe DRP - Prizren dhe Gjakovë, ku zyrtarët e tyre kanë një kuotë të lartë të realizimit në raport me ngarkesat me lëndë.

**Tabela nr. 2 - Indikatorët e performances dhe efektivitetit të drejtorive rajonale, në raport me ngarkesën e policëve me urdhëresa të gjykatave (2019-2020)**

	Statusi	Fe	Gjk	Gjl	MJ	MV	Pe	Pr	Pz	Total
2019	Personeli	310	255	386	323	359	395	871	330	3.229
	Gjithsej	4.970	2.663	1.782	1.510	525	5.176	13.377	4.700	34.703
	Ngarkesa	16	10	5	5	1.5	13	15	14	11
	Realizuar	8	8	3	3	1.3	11	7	11	7
	%	50%	80%	60%	60%	87%	85%	47%	79%	64%
	Raporti <sup>10</sup>	8:8	8:2	3:2	3:2	1.3:1.2	11:2	7:8	11:3	7:4
2020	Personeli	327	280	410	355	360	415	1.073	343	3.563
	Gjithsej	4.258	2.301	1.315	1.368	354	2.669	11.543	2.897	26.705
	Ngarkesa	13	8	3.2	3.9	1	6	11	8	7
	Realizuar	6	6	1.6	2.2	0.7	5	3.5	6	4
	%	46%	75%	50%	56%	70%	83%	32%	75%	57%
	Raporti	6:7	6:2	1.6:1.6	2.2:1.7	0.7:0.3	5:1	3.5:7.5	6:2	4:3

<sup>10</sup> Këtu paraqitet raporti ndërmjet urdhëresave të realizuara në njëren anë dhe atyre të pa realizuara dhe të parashkuara në anën tjetër.

### **Rekomandimi nr. 3**

*IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal të Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme që në bashkëpunim dhe koordinim me komandantët e stacioneve policore që kanë performuar jo kënaqshëm, të shtojnë përpjekjet drejt ngritjes së efektivitetit dhe performancës në realizimin e urdhëresave të gjykatave.*

### **3.3. Aktivitetet policore në administrimin e urdhëresave të gjykatave**

3.3.1. Gjatë inspektimit, fokus i IPK-së ka qenë identifikimi i llojeve e kategorive të urdhëresave të gjykatave që pranohen nga Policia për ekzekutim. Në bazë të të dhënave të siguruara nga terreni, Policia apo stacionet policore pranojnë numër mjaft të konsiderueshëm të urdhëresave të gjykatave kompetente duke përfshirë urdhëresa për ekzekutim dënimi (me burg), urdhër arreste (365 ditë), letër rreshtime, urdhëresa për kohë të caktuar (për paraqitje në seanca gjyqësore), urdhëresa për mbikëqyrjen e masave të arrestit shtëpiak, urdhëresa për verifikim të adresave, si dhe urdhëresa për dërgimin e shkresave të gjykatave kompetente (thirrje nga gjykata dhe vendime gjyqësore) kur përpjekjet për dërgimin e shkresave me postë apo nëpërmjet të organit kompetent komunal nuk kanë sukses. Shikuar nga aspekti i kompetencës lëndore të rasteve, Policia pranon gjithë kategoritë e urdhëresave të cekur më lartë, për rastet e gjykatave me kompetencë lëndore penale. Kurse sa i përket rasteve të lëndëve me kompetencë lëndore, Policia ngarkohet me ekzekutim të urdhëresave për rastet e gjykatave me kompetencë lëndore të kundërvajtjes dhe atë për urdhëresa për ekzekutim me burgim (rastet kur dënimet me gjobë konvertohen me burg), urdhëresa për kohë të caktuar (për paraqitje në seanca gjyqësore), si dhe urdhëresa për verifikim të adresave.

3.3.2. Gjetjet e inspektimit pasqyrojnë se drejtoritë rajonale, stacionet policore aplikojnë praktika të ndryshme lidhur me pranimin, trajtimin, sistemimin dhe raportimin e lëndëve të urdhëresave të gjykatave. Sa i përket mënyrës së pranimit të urdhëresave për disa drejtori rajonale, ato pranohen nga stacionet dhe atë secili prej tyre pranon urdhëresa nga gjykatat për zonën e përgjegjësisë si kompetencë territoriale e stacionit përkatës, kurse në disa drejtori, përveç stacioneve, urdhëresa të gjykatave pranon edhe niveli rajonal. Lidhur me atë, se cilat njësi në stacione policore ngarkohen me zbatimin e urdhëresave të gjykatave, bazuar në informatat e inspektimit rrjedh se nëpër stacione policore varësisht nga specifikat e tyre dhe gjendjes me burime njerëzore, në shumicën prej tyre, barra e ekzekutimit të urdhëresave të gjykatave bie mbi sektorët dhe ekipet reaguese, por ka disa stacione policore, si Prishtinë Jug, Veriu, Podujevë, Fushë Kosovë, Gjakovë, Graçanicë, etj, ku janë caktuar ekipe apo zyrtarë policor, që merren veçanërisht me trajtimin e urdhëresave. IPK gjatë këtij inspektimi nuk është fokusuar për vlerësimin e praktikave të aplikuara organizative, sepse PSO mbi Ekzekutimin e Urdhëresave të Gjykatave (edhe pse si një dokument i vjetëruar) u ka lënë në kompetencë drejtorive rajonale dhe stacioneve policore, të përcaktojnë mënyrën e organizimit për ekzekutimin e tyre. Në stacione policore janë hasur praktika të ndryshme në administrimin e urdhëresave, dhe në rastet kur nuk ka njësi të veçantë policore që merren me administrimin e tyre, administrohen nga shefat e sektorëve, shefat e hetimeve, zyrtar civil apo mbikëqyrësit e sektorëve. Në rastet kur urdhëresat e gjykatave pranohen nga niveli rajonal, ato regjistrohen në SIPK dhe më pas u shpërndahen stacioneve, por ka praktika kur stacionet policore i pranojnë urdhëresat direkt nga gjykata. Lidhur me pranimin e urdhëresave të gjykatave mbahen regjistra të veçantë të pranimit - dorëzimit me informata te nevojshme. Nga takimet e realizuara me administrues të urdhëresave të gjykatave, janë diskutuar edhe modalitetet e procedimit të urdhëresave, andaj Policia duhet të analizojë se cila nga praktikat e përdorura do të mund të jetë më efikase dhe më efektive.

**Rekomandimi nr. 4**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që të shqyrtojë mundësinë e standardizimit të mënyrës së pranimit të urdhëresave (përmes regjioneve apo stacioneve), duke përzgjedhur njërën prej mënyrave më efektive, që ofron mundësi për reagim më të shpejt policor dhe që shkurton kohën që ato të arrijnë tek njësitë që do të merren me ekzekutimin e tyre.*

3.3.3. IPK është fokusuar në evidencat e SIPK mbi urdhëresat, me prioritet në ato të parashkruara (të skaduara). Siç u potencua edhe më lartë, ka disa praktika sa i përket evidentimit të urdhëresave në SIPK. Zakonisht disa DRP (Prishtinë, Ferizaj) i pranojnë urdhëresat dhe zyrtarët e SIPK-ut i regjistrojnë ato në bazën e të dhënave, e më pas ua shpërndajnë stacioneve. Praktikë tjetër zbatohet në disa DRP tjera ku stacionet vet i evidentojnë urdhëresat në SIPK. Nga gjithsej 2.313 urdhëresa të parashkruar (skaduar) për vitet 2019-2020, IPK ka ekzaminuar 171 mostra për të verifikuar nëse ato janë regjistruar në SIPK. Nga kontrolli i mostrave rezultoi se 87% (149) janë regjistruar në SIPK, derisa për 13% të mostrave (22) nuk ka të dhëna në SIPK. Numri më i madh i mostrave të pa regjistruara në SIPK i takojnë DRP - Ferizaj me 16 sosh, pasuar me Prizrenin me katër (4) dhe Prishtinën me dy (2). Mungesa e informatave në SIPK vështirëson apo thënë ndryshe, pamundëson ndjekje dhe kapje të kryesve të veprave të ndryshme, me ç'rast ata mund të qarkullojnë lirshëm nëpër rrugët dhe pikë kalimet kufitare, pa u kapur nga organet e ndjekjes. IPK është interesuar të dijë nëse personat e kërkuar me këto urdhëresa, të paregjistruara në SIPK (urdhër arreste - letër rreshtime), kanë lëvizur përmes pikave të kalimit kufitar. Nga verifikimi i realizuar në Sistemin e Menaxhimit Kufitar (BMS) ka rezultuar se nga gjithsej 22 persona të kërkuar me urdhëresa të pa regjistruara, në pika të kalimit kufitar kanë lëvizur 11 prej tyre, në periudhën për të cilën ka pasur në fuqi urdhra të gjykatave për personat e tillë (6 letër rreshtime dhe 5 urdhër arreste). Personat e kërkuar nuk kanë mundur të jenë pjesë e Stop Listës në mungesë të regjistrimit<sup>11</sup>. Vlerësohet se mos regjistrimi i urdhëresave konsiderohet shkelje. IPK ka trajtuar këtë me personat përgjegjës të DRP - Ferizaj, kurse të njëjtit janë deklaruar se disa urdhëresa janë për kohë të caktuar dhe zakonisht kërkohet që personat të arrestohen dhe të sillen para gjykatës, gjatë ditëve të punës, nga ora 08.00-16.00. IPK-ja vlerëson se në Ferizaj aplikohet praktikë e pashembullt, ngase kjo kategori e urdhëresave nuk regjistrohet në SIPK me arsyetimin se gjykata kërkon arrestimin vetëm në periudhë të caktuar. Kjo praktikë nuk është konform rregullave dhe procedurave policore dhe si e tillë ndikon negativisht në efektivitetin e ndjekjes dhe kapjes së kryesve të veprave penale.

**Tabela nr. 3 - Pasqyrë përmbledhëse mbi evidentimin e urdhëresave të parashkruara në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (2019-2020)**

DRP	Numri i rasteve të parashkruara	Mostra të kontrolluara	Urdhëresa të regjistruara	Urdhëresa të paregjistruara <sup>12</sup>
Ferizaj	335	28	12	16
Gjakovë	299	21	21	0
Gjilan	349	17	17	0
Mitrovicë Jugu	102	8	8	0
Mitrovicë Veriu	32	4	4	0

<sup>11</sup> Të dhënat e personave në kërkim me urdhër arrest / letër rreshtim apo urdhëresa tjera të gjykatave vendore dhe kërkimet policore që regjistrohen në SIPK, barten automatikisht në Stop Listë të Sistemit SMK (BMS).

<sup>12</sup> DRP - Ferizaj (P.Nr.1103/16, P.Nr.293/16, P.Nr.31/15, P.Nr.571/15, P.Nr.871/15, P.Nr.1472/17, PKR.Nr.655/14, P.Nr.160/19, P.Nr.971/19, P.Nr.45/2014, P.Nr.1262/15, P.Nr.2773/17, P.Nr.223/18, P.Nr.610/17, PKR.Nr.263/14 dhe P.Nr.30/13), DRP - Prizren (P.Nr.190/15, EDGJ.Nr.758/16, P.Nr.1437/2016-V dhe P.Nr.1479/2014), DRP - Prishtinë (ED.Nr.494/2016 dhe PPR.2/2017).

Pejë	114	11	11	0
Prishtinë	981	76	74	2
Prizren	101	6	2	4
<b>Gjithsej</b>	<b>2.313</b>	<b>171</b>	<b>149</b>	<b>22</b>

3.3.4. Është identifikuar edhe një numër i madh i urdhëresave të regjistruara me vonesë në SIPK. Në këtë Raport, IPK-ja pasqyron vetëm disa nga rastet kur regjistrimet në SIPK janë bërë me disa muaj vonesë. Nga kontrolli i 171 urdhëresave të parashkuara në nivel të të gjitha drejtorive rajonale janë hasur 21 prej tyre (12%), që janë regjistruar me vonesë në SIPK prej më shumë se një muaj. Në këtë Raport pasqyrohen vetëm disa nga rastet kur evidentimi i urdhëresave ka ndodhur pas më shumë se një muaj. Në kuadër të DRP - Ferizaj është identifikuar Urdhëresa ED.Nr.623/2013 (Hani i Elezit). Në kuadër të DRP - Gjakovë janë identifikuar Urdhëresa me burg EDGJ.Nr.354/16 (Gjakovë) dhe Urdhër arresti EDGJ.Nr.402/2016 (Gjakovë). Në kuadër të DRP - Gjilan janë hasur Urdhër arresti P.Nr.349/2019 (Gjilan), Urdhër arresti PPr.KR.Nr.148/2020 (Gjilan), Urdhëresa P.Nr.725/2019 (Gjilan), Urdhër arresti P.Nr.1062/2019 (Gjilan), Urdhër arresti P.Nr.629/2019 (Gjilan), Urdhëresa P.Nr.89/19 (Gjilan), Urdhër arresti P.Nr.945/2016 (Gjilan), Urdhër arresti (P.Nr.1016/19 (Gjilan), PPr.Kr.Nr.148/2020 (Gjilan), Urdhër arresti P.Nr.1099/2018 (Gjilan), Urdhër arresti P.Nr.145/2019 (Gjilan), Urdhër arresti P.Nr.1136/2016, Urdhër arresti P.Nr.1119/2019 (Gjilan). Në kuadër të DRP - Mitrovicë Jugu është identifikuar Urdhër arresti P.Nr.3637/13 (Skënderaj). Në kuadër të DRP - Prishtinë janë identifikuar: Letër rreshtimi P.Nr.1/09 (Fushë Kosovë), Urdhër arresti PMNr.308/2017 (Lipjan) dhe Urdhër arresti PN.Nr.64/18 (Graçanicë). Nga urdhëresat e pasqyruara vërehet se vonesat më evidente kanë qenë në kuadër të DRP - Gjilan. Kurse, dobësi të tilla nuk janë hasur në DRP-të e Pejës, Prizrenit dhe Mitrovicë Veriu. Këto vonesa nuk duhet toleruar në të ardhmen, ngase mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimeve policore dhe u japin hapësirë të dyshuarve për vepra penale që të lëvizin lirshëm.

#### **Rekomandimi nr. 5**

*IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal dhe komandantëve të stacioneve policore që të sigurohen se të gjitha urdhëresat e gjykatave evidentohen në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës dhe se regjistrimi i tyre bëhet me kohë, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe Procedurat Standarde të Operimit.*

3.3.5. Procedura Standarde e Operimit - Ekzekutimi i Urdhëresave të Gjykatave ka përcaktuar në Kapitullin III - Procedura, pika 3.3 (Aktivitetet policore) që “policët të cilët bëjnë ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave duhet të raportojnë me shkrim për çdo aktivitet të tyre për secilën urdhëresë veç e veç dhe secilës urdhëresë veç e veç duhet t’i bashkëngjitet raport për aktivitetet e policisë derisa urdhëresa e njëjtë është ekzekutuar”. Inspektimi gjatë kontrollit të dosjeve ka gjetur se pak është punuar në kompletimin e dosjeve të urdhëresave të gjykatave. Në shumë raste, raportet mbi veprimet policore nuk gjenden të bashkëngjitura dhe në shumë të tjera ato mungojnë fare. Nga kontrolli i 171 dosjeve të urdhëresave të parashkuara, 61 lëndë pasqyrojnë se stacionet policore kanë ndërmarrë nga një veprim në ekzekutimin e tyre, 17 lëndë pasqyrojnë nga dy (2) veprime policore, 12 lëndë pasqyrojnë nga tre (3) veprime policore, një (1) lëndë me 4 veprime, një (1) me 5 veprime, një (1) me 6 veprime, një (1) me shtatë (7) veprime, kurse 77 lëndë të tjera nuk kanë pasur të bashkëngjitur të dhëna mbi veprimet e ndërmarra policore. IPK nuk është ndarë e kënaqur me performancën e stacioneve policore sa i përket veprimeve policore të ndërmarra në ekzekutimin e urdhëresave. Sipas matjeve të bëra vetëm në 19% të rasteve që lidhen me mostrat e urdhëresave

të parashkuara (18 raste nga 94 mostra që kanë të bashkëngjitura veprimet policore), stacionet kanë ndërmarrë veprime policore brenda 10 ditëve të para nga pranimi i urdhëresave dhe kjo tregon që stacionet policore kanë ndërmarr veprime të vonuara. Ka ndodhur që veprimet policore janë ndërmarrë me vonesë deri pak para skadimit të afateve kohore të urdhëresave të gjykatave. PSO-Ekzekutimi i Urdhëresave të Gjykatave lidhur ekzekutimin përcakton se “të gjitha urdhëresat e gjykatave të pranuar në stacione policore duhet të ekzekutohen në kohë sa më të shpejtë që është e mundur”<sup>13</sup>. Po ashtu duhet cekur edhe se stacionet policore duhet t’iu kushtojnë kujdes dosjeve të urdhëresave, për të dëshmuar në çdo kohë veprimet policore në ekzekutimin e urdhëresave.

#### **Rekomandimi nr. 6**

*IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi njësitë që administrojnë urdhëresat e gjykatave, njësitë policore, qoftë ekipet sektoriale apo ekipet reaguese, që të marrin më me seriozitet dhe përkushtim angazhimet në ekzekutimin e urdhëresave, në mënyrë që aktivitetet të jenë më të shumta në kapjen e të dyshuarve dhe të dënuarve, drejt krijimit të një ambienti më të sigurt dhe ngritjes së bashkëpunimit me gjykatat.*

3.3.6. Procedurat operuese kanë paraparë përditësimin e informatave në bazën e të dhënave SIPK. Inspektimi vë në pah praktika të ndryshme në përditësimin e informatave lidhur me urdhëresat e gjykatave. Një numër drejtorish dhe stacionesh policore aplikojnë heqjen e urdhër arresteve nga SIPK-u nga momenti kur skadon 365 ditëshi. Disa të tjera, tërheqjen e urdhëresave nga SIPK-u e praktikojnë vetëm pasi të kenë pranuar shkresat mbi revokimin (tërheqjen) nga gjykatat. IPK-ja vlerëson se po përdoren dy standarde lidhur me përditësimin e të dhënave. Standardi që tërheqja e urdhër arresteve të bëhet vetëm pas revokimit nga gjykata, po tregohet jo sa duhet efektive, meqë këto të fundit shpesh edhe nuk veprojnë. Në rastet kur skadojnë afatet e urdhër arresteve, nëse ato nuk pasohen me urdhra tjerë, mostërheqja nga SIPK-u mund të konsiderohet si shkelje e të drejtave të njeriut. Kjo situatë ka për pasojë atë se urdhëresat e gjykatave edhe pse skadojnë, vazhdojnë të mbeten aktive. Gjatë inspektimit është vërejtur se edhe pas skadimit të afateve të urdhër arresteve, shumë herë ato nuk tërhiqen, apo edhe nëse tërhiqen, kjo ndodhë me vonesa. IPK-ja ka identifikuar një numër të madh urdhëresash të gjykatave, të cilat janë tërhequr me vonesë. Meqë janë verifikuar vetëm urdhëresat e parashkuara (skaduara), nga mostra prej 171 sosh, janë hasur 15 prej tyre që janë tërhequr me vonesa të mëdha nga SIPK-u. Në DRP-Gjakovë janë identifikuar Urdhër arresti P.Nr.33/2017, Urdhëresa me burg EDGJ.Nr.118/16, Urdhër arresti P.Nr.231/17 dhe Urdhër arresti P.Nr.609/15. Në kuadër të DRP - Mitrovicë Jugu është identifikuar Urdhër arresti P.Nr.3637/13. Në kuadër të DRP - Mitrovicë Veriu janë identifikuar Urdhër arrestet PPR.Nr.229/16 e IIIIc.39/18. Në kuadër të DRP-Pejë janë identifikuar Urdhër arrestet P.Nr.337/18 e PPR.Nr.21/19. Në kuadër të DRP - Prishtinë janë identifikuar Urdhër arrestet P.nr.1438/13, P.Nr.710/17, PPRKR.Nr.351/18, P.Nr.1080/13, PKR.Nr.79/19 dhe P.Nr.730/18. IPK-ja vlerëson se vonesat për tërheqje nga SIPK shkaktohen për disa arsye: *së pari*, gjykatat nuk janë shumë azhure në konfirmimin e revokimit apo vazhdimin të urdhëresave me vendime pasuese, *së dyti*, disa prej administruesve të urdhëresave hezitojnë të tërheqin urdhëresat nga Sistemi pa pranuar shkresë nga gjykatat, dhe *së treti*, nuk përjashtohet dhe neglizhenca dhe serioziteti jo i duhur në përditësimin e të dhënave. IPK vlerëson se duhet ngritur bashkëpunimi me gjykatat dhe gjithmonë sa herë që nuk ka njoftime nga kjo instancë, të njoftohen ato mbi veprimet në ç’regjistrimin e urdhëresave.

<sup>13</sup> Procedura Standarde e Operimit - Ekzekutimi i Urdhëresave të Gjykatave, Kapitulli III - Procedura (Ekzekutimi).

***Rekomandimi nr. 7***

*IPK-ja u rekomandon drejtorëve rajonal dhe komandantëve të stacioneve policore, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi njësitë që administrojnë urdhëresat e gjykatave dhe zyrtarët e SIPK-ut, në mënyrë që përditësimi i të dhënave mbi urdhëresat e skaduara, të ndodhë me kohë. Në këtë drejtim, administratorët e urdhëresave të ngrisin bashkëpunimin me gjykatat lidhur me statusin e lëndëve, drejt përditësimit të rregullt të rasteve.*



#### 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

##### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 30.12.2021, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të Veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioriteti	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Policisë së Kosovës, të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të Procedurës Standarde të Operimit për Ekzekutimin e Urdhërësave të Gjykatave, duke synuar ndarjen e qartë të detyrave të personelit, të ngarkuar në administrimin dhe ekzekutimin e tyre, varësisht organizimit brenda stacioneve policore.</i>	-I-	<i>PK ka pranuar raportin e inspektimit nga IPK, dhe pajtohet me rekomandimin Nr.1, ku PK , Departamenti për Operacione do të azhurnoj PSO n për Ekzekutimin e Urdhërësave të Gjykatave përmes se cilës do te eliminoj shumicën e mangësive te evidentuara ne këtë inspektim duke u siguruar ndarjen e qartë të detyrave të personelit, të ngarkuar në administrimin dhe ekzekutimin e tyre, varësisht organizimit brenda stacioneve policore Standardizimin dhe unifikimin e veprimeve dhe metodave te punës.</i>	2022
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që të mobilizohet në nxjerrjen dhe zbatimin e Pakos së veprimeve, që do të ngriste cilësinë e raportimit dhe mbajtjes së duhur të evidencave mbi urdhërësat. Pakoja duhet të marrë parasysh stabilizimin e vendeve të punës në administrimin e urdhërësave, organizimin e trajnimit të personelit, nxjerrjen e Udhëzuesit për administrim të urdhërësave, rishikimin e statusit të urdhërësave dhe përpunimin e të dhënave.</i>	-I-	<i>PK/DO përmes te gjeturave te inspektimit do të analizoj dhe rishikoj mënyrën e veprimeve të Drejtorive Rajonale dhe Stacioneve policore përkatëse, në mënyrë që përmes një pakoje veprimesh te eliminohen mangësitë e gjetura ne inspektim sa i përket urdhërësave si në pranim, zbatim, evidentim dhe raportim.</i>	2022
3.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal të Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme që në bashkëpunim dhe koordinim me komandantët e stacioneve</i>	-I-	<i>PK-DO-DSP përmes hapave qe do ndërmarr ne rekomandimet si me lart përveç tjerash do të kërkoj angazhim shtese nga te gjitha Drejtoritë Rajonale dhe Stac</i>	2022

	<i>policore që kanë performuar jo kënaqshëm, të shtojnë përpjekjet drejt ngritjes së efektivitetit dhe performancës në realizimin e urdhëresave të gjykatave.</i>		<i>Policore për ngritje të performancës në realizim të urdhëresave.</i>	
4.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që të shqyrtojë mundësinë e standardizimit të mënyrës së pranimit të urdhëresave (përmes regjioneve apo stacioneve), duke përzgjedhur njërin prej mënyrave më efikase, që ofron mundësi për reagim më të shpejt policor dhe që shkurton kohën që ato të arrijnë tek njësitë që do të merren me ekzekutimin e tyre.</i>	<i>-I-</i>	<i>Pranimi, ekzekutimi dhe evidentimi i urdhëresave të bëhet sipas PSO-së, " Sistemet informative te PK s" me nr.: DPPK-01/0852-21 në mënyrë dhe kohë optimale.</i>	2022
5.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal dhe komandantëve të stacioneve policore që të sigurohen se të gjitha urdhëresat e gjykatave evidentohen në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës dhe se regjistrimi i tyre bëhet me kohë, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe Procedurat Standarde të Operimit.</i>	<i>-I-</i>	<i>PK-DO-DSP do të kërkojë nga Drejtoritë Rajonale që ZP kompetent të veprojnë në regjistrim të Urdhëresave në SIPK sipas PSO-së dhe pa humbur kohë të futen të futën të gjitha urdhëresat në sistem të kërkimit.  E njëjta do te kërkohet edhe nga DH dhe DK.</i>	<i>Menjëherë (2022)</i>
6.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi njësitë që administrojnë urdhëresat e gjykatave, njësitë policore, qoftë ekipet sektoriale apo ekipet reaguese, që të marrin më me seriozitet dhe përkushtim angazhimet në ekzekutimin e urdhëresave, në mënyrë që aktivitetet të jenë më të shumta në kapjen e të dyshuarve dhe të dënuarve, drejt krijimit të një ambient më të sigurt dhe ngritjes së bashkëpunimit me gjykatat.</i>	<i>-I-</i>	<i>DO-DSP do të kërkojë nga Drejtoritë Rajonale që ZP kompetent të veprojnë konform PSO-së dhe pa humbur kohë të futen të gjitha urdhëresat në sistem të kërkimit dhe të realizohen ne shtimin e efikasitetit dhe efektivitetit ne punë për zbatimin dhe realizimin e tyre</i>	<i>Menjëherë (2022)</i>
7.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtorëve rajonal dhe komandantëve të stacioneve policore, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi njësitë që administrojnë urdhëresat e gjykatave dhe</i>	<i>-I-</i>	<i>DO-DSP do të realizoj inspektime në Drejtori Rajonale lidhur me zbatim të urdhëresave, realizim, evidentimin dhe raportimin e tyre ne mënyrë uniforme dhe te saktë . Gjithashtu do te behet përpjekje ne</i>	2022

<p><i>zyrtarët e SIPK-ut, në mënyrë që përditësimi i të dhënave mbi urdhëresat e skaduara, të ndodhë me kohë. Në këtë drejtim, administratorët e urdhëresave të ngrisin bashkëpunimin me gjykatat lidhur me statusin e lëndëve, drejt përditësimit të rregullt të rasteve.</i></p>	<p><i>menyre qe te vendoset ne SIPK mundësia qe sistemi ne mënyrë automatike te tregoj për 365 dhiteshin e s kadencës se urdhëresave.</i></p>	
--	---	--